

STATUTI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TALENT BRIDGE ALBANIA” SH.P.K.

Sot, më datë 27.06.2024, Ortaku **Xhoana MERKAJ** bazuar në vullnetin e saj të lirë themelon shoqërinë “**TALENT BRIDGE ALBANIA**” SH.P.K., në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe vendosen të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**TALENT BRIDGE ALBANIA**” SH.P.K.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 27.06.2024 une, themeluesja, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**TALENT BRIDGE ALBANIA**”SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

Znj.Xhoana MERKAJ, atësia: Fatmir, e datëlindjes 15.12.1995, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 032575753 dhe Numër Personal: J56215053F, lindur në Poliçan, Skrapar dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“Zef Jubani”, Ndërtesa Nr.8, H.5, Apartamenti 28, Kodi postar 1019.

Neni 2
Selia

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Njësia Administrative Nr.5, Rruga: Zef Jubani, Zona Kadastrale 8270, Pasuria Nr.5/655+2+3 Volumi 77, Faqe 198, SHK.2, Ap. 3, Tiranë.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, informimit, këshillimit, si dhe të përfaqësimit në procedurat e aplikimeve për punësim në vendet e BE dhe jo vetëm.
- Furnizimin e kompanive vendase dhe të huaja, me fuqi punëtore të fushave të ndryshme.
- Zhvillimin dhe kryerjen e aktiviteteve të shërbimeve të ndryshme, në fushën e hotelerisë, të restoranteve, të aktiviteteve turistike, transportuese, menaxheriale; atë të konsulentëve dhe studimeve të të gjitha llojeve, si dhe kryerjen e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht në atë të hotelerisë.
- Investime në kapitale dhe mjete të tjera financiare për blerje pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme duke mos përjashtuar vazhdimësinë e aktivitetit që ka të bëjë me: shitje, blerje, qiraje, franshize, enfiteoze; për të arritur qëllimet e Shoqërisë.
- Kryerjen e të gjitha operacioneve financiare bankare si depozitime, kreditime, likuidime të parave, në kushtet e përcaktuara nga legjistacioni shqiptar.
- Realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, partneriteteve, shoqërive të përbashkëta apo i formave të tjera të lejuara nga legjistacioni shqiptar, me persona fizikë apo juridikë, shqiptarë dhe të huaj, për të realizuar operacione industriale, tregtare apo financiare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe në interes të Shoqërisë.
- Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtit ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt operacione tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.
- Ndërtim objektësh, ura, prita, ujësjellës, kanalizime, hidrocentrale, punime mbrojtëse, etj. Ndërtime civile dhe ekonomike.
- Rikonstruksion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash.
- Prodhim gëresh dekorativ dhe inerte.
- Pastrim dhe gjelberim i hapësirave publike, si dhe rehabilitimin e objekteve pas shfrytëzimit.
- Instalime elektrike dhe hidraulike.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje rrugë dhe kanalizime.
- Prodhimin e materialeve të ndërtimit për punime ndërtimi në hoteleri-turizëm.
- Ngjritjen dhe mbulimin e konstruksioneve të kulmeve.
- Punime dhe shërbime të tjera të specializuara në ndërtim, si: suvatime dhe montime dyer, dritare, shkalle etj., gjithashtu dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera të ngjashme me të.
- Punime dheu, sistemin tarracash të terreneve.
- Tregti pajisjesh të ndryshme, të materialeve të ndërtimit, të mallra të import-eksportit, me shumicë dhe pakicë.
- Ushtrimin e aktivitetit të shfrytëzimit mineral për mineralin gelqeror- dekorativ, por jo vetëm.
- Menaxhimin, shfrytëzimin, shitjen apo blerjen e burimeve natyrore të tokës dhe të nentokës të burimeve natyrore, gjeometrike, hidroelektrike ujor dhe solar, si në Shqipëri dhe jashtë saj.
- Kryerja e punëve vete ose duke ju referuar të tjerëve për punë përfundimtare për shfrytëzimin e burimeve natyrore të tokës dhe të nentokës, të burimeve natyrore gjeotermike, hidroelektrike, ujore dhe solare, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- Përpunimi dhe tregtimi i burimeve natyrore që vijnë nga toka dhe nga nentoka, vete ose

duke ju referuar te treteve.

- Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 000 (njëqindë mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij, si më poshtë:
Ortaku i vetëm themelues është:

Znj.Xhoana MERKAJ, është zotëruese e 1(një)kuote të kapitalit, me vlerë 100 000 (njëqinde mijë) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Nëe asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve perderisa nuk

parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimarrës

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te ketij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkrese ose mesazh elektronik, duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregetarët dhe Shoqerite Tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjit sipermendur.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

Neni 11 Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Përgjashtimi nga e drejta e votës


Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nj i perfaqesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interesi, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.


Neni 13 Administrimi


Administrator i shoqërisë emërohet:



Znj.Enisilda Qorraj atësia: Pellumb, e datëlindjes 02.11.1987, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 039178379 dhe Numër Personal: I76102001C, lindur në Corovode, Skrapar dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“Hamdi Cenoymeri”, Ndërtesa Nr.054.

Znj.Enisilda Qorraj, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 1 vjecare.

Emer Mbiemer


Nënshkrimi


Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 14 **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) te përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së pergjithshme për miratim;
- d) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) te raportojë përpara asamblesë së pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) te kryjane detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem e të jashtezakonshem. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Administratorit**



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administratori detyrohet:


1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogaritë vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për



investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

Neni 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqëri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket..

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 Riorganizimi i shoqërisë: Baskimi- Ndarja

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2012 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“.

Neni 20 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e

legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TALENT BRIDGE ALBANIA”

Xhoana MERKAJ

